



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO



Në bazë të dispozitave të nenit 4 dhe dispozitave të nenit 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të Republikës së Kosovës Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/1-205, dt.28 tetor 2010, dispozitave të nenit 11, 82 dhe 109 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-40, dhe nenit 38 pika "c" të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET shpronësimi për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik ndërtimin - sigurimin e tokës për nevoja të ndërtimit të rrugës të paraparë sipas Projektit "Zgjerimi i Rrugës Hamdi Kurteshi – Pjesa mbi lumin Shtanishorka - Gjiçan", ngastra kadastrale, respektivisht pjesa e ngastrës kadastrale:

- Pjesa e ngastrës kadastrale nr.P-70403013-02221-0, lloji i njësisë – parcelë, lloji i pronës-pronë private, zona – U, sipërfaqja 1947 m², vendi i quajtur " Bashqe" lloji i shfrytëzimit të parcelës – bujqësore dhe ndërtimore, shfrytëzimi aktual- arë me sipërfaqe 1327 m², oborr me sipërfaqe 500 m², dhe shtëpi me sipërfaqe 120 m², klasa e kualitetit- arë e klasit 1, bashkëpronar [redacted] me vendbanim në Gjiçan, pjesa e pronës 1/2, dhe [redacted], me vendbanim në Gjiçan, pjesa e pronës 1/2, sipërfaqja për shpronësim 88 m², Zona Kadastrale Gjiçan.

II. Obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që brenda 5 ditëve të punës t'ju dërgojë Vendimin Përfundimtar personave të identifikuar në këtë Vendim.

IV. Pjesë e këtij Vendimi është akt i lerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompenzimit për ata pronar apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

V. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi obligohet **Organi Shpronësues, që brenda afatit prej 24 muaj** të paguaj plotësisht shumën e kompenzimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raporti të vlerësimit të Zyrës Për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, Departamenti i Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

VI. Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e shpall Vendimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

VII. Kundër këtij Vendimi, brenda 30 ditëve pas hyrjes së tij në fuqi kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Komunale në Gjilan, çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, dhe atë vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit. Paraqitja e ankesës ndaj vendimit të organit shpronësimit dhe as paraqitja e apelit ndaj aktgjyqimit të gjykatës mbi ankesën nuk ndikon në vendimin përkatës ose të drejtën e Organit Shpronësues që të vazhdojë zbatimin e vendimit përkatës, në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të Republikës së Kosovës Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/1-205, dt.28 tetor 2010 .

VIII. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe regjistrimit në RDPP obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë ; Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IX. Vendimi Përfundimtar hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit në njërën nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi i dërgohet :

1. Pronarëve ose Zotëruesëve të Interesit
2. Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
3. Drejtorisë për Financa dhe Buxhet
4. Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
5. Arkivit

Kryetari i Komunës

Alban HYSENI

